

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Bashkia Krujë

VENDIM

Nr. 149 datë 15. 12.2017

“Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë Krujë e njërive administrative në varësi të saj për vitin 2018”.

Këshilli i bashkisë Krujë në mbledhjen e tij të datës 15.11.2017, në mbështetje të nenit 34, 40, 41, shkronja “dh” e nenit 54, pikës 3 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ndryshuar, ligjit nr130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, Udhëzimit nr.2 datë 6.2.2012 të ministrisë financave “Mbi procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, germa “dh”, me propozim të kryetarit të bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin maksimal të punonjësve organik të bashkisë Krujë e njërive administrative në varësi të saj me **356** punonjës, të ndarë: Bashkia Krujë=**141**, NA Fushë-Krujë=**75**, NA Thumanë=**67**, NA Nikël=**33**, NA Bubq=**29** dhe NA Cudhi=**11**, në total=**356** punonjës.
2. Të miratojë numrin e punonjësve të funksioneve të deleguara prej **152** punonjësve, të ndara: Arsimi parashkollor(Kopeshtet e femijeve +QKF)=**77** punonjës, shërbimet mbështetëse në arsimin bazë, 9 vjeçar(parashkollori+Qendrat kulturore)=**31** punonjës, shërbimet mbështetëse, arsimit mesëm=**7** punonjës, Administrimi i pyjeve=**6** punonjës, Ujitja dhe kullimi=**7** punonjës, Shërbimi i Mbrotjes nga Zjarri dhe Shpetimi=**14** punonjës, Rrugët rurale=**6** punonjës, QKB=**2** punonjës.
3. Punonjës sezonal në sektorin e pyjeve me kontratë tre mujore =**4** punonjës.
4. Numri i përgjithshëm i punonjësve organik plus funksionet e deleguara është **510** punonjës.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Durrës.

Kryetari i Këshillit

